



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 26 nëntor 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi.

Mungoi: Shaip Muja e Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Faik Korenica – GLPS, Florie Mehmeti – KDI, Blerim Dervishi, Besarta Zuka e Liridona Dobërdolani – NDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d i d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga e mbledhjet e mbajtura, më 31 tetor dhe 15 nëntor 2012.

3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Albin Kurti, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, tha se grupi punues pas një pune disa mujore, ka arritur ta përmbyllë punën me këtë raport. Gjatë kohës së mbikëqyrjes, grupi punues, është takuar me zyrtarë të MPJ-së dhe ka pasur takime me ambasadorë. Grupi punues gjatë punës së tij, ka marrë për bazë edhe ekspertizën e ekspertit Dren Doli, lidhur me përputhshmërinë e ligjit me aktet nënligjore. Raporti theksoi se mund të plotësohet e ndryshohet edhe me vërejtjet dhe plotësimet nga anëtarët e Komisionit dhe më pas të përcillet në Kuvend.

Hydajet Hyseni, theksoi se në këtë raport, është përmbledhur e gjithë puna e bërë rreth mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, si dhe puna e bërë nga angazhimi i ekspertit. Duke cekur mënyrën e trajtimit të stafit të ministrisë, i cili ka punuar jashtë, dhe atij, i cili punon brenda, propozoi që në draft-raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, kërkesa që ka të bëjë me pozitën e shërbyesve civilë, të mos jetë shumë eksplicite por të thuhet, që të harmonizohet me kuadër ligjor që rregullojnë statusin e shërbyesit civil.

Skender Hyseni, theksoi se në çdo vend të botës, përmes ligjeve është i rregulluar qartë statusi i diplomatëve dhe ai i shërbyesve civilë, të cilët dallojnë, ndërsa, çështja e kompetencave zgjidhet përmes mekanizmave që ekzekutojnë dispozita, sipas ligjit. Ministrit, nuk do të duhej t'i kufizoheshin kompetencat sepse zgjedhja e tij, nënkupton edhe zbatimin e politikave të caktuara të tij. Lidhur me raportin, tha se përfshinë shumë aspekte ligjore, megjithatë do të duhej të përfshinte në radhë të parë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe respektimin e normave ligjore. Si rast konkret ceku informatën se, aplikacionet e 600 kandidatëve në MPJ, presin tash një vit që të trajtohen, gjë që paraqet shkelje të çdo norme ligjore. Kjo çështje, tha Hyseni, se do të duhej të ishte pjesë e këtij raporti.

Enis Kervan, përkrahu raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, dhe shtoi se ndoshta do të ishte mirë që në raport të ceket edhe se, është koha që ligji të plotësohet e ndryshohet. Ai theksoi se në raport nuk figurojnë emrat e ambasadorëve, me të cilët është takuar grupi punues, dhe njëkohësisht propozoi që në të ardhmen, do të kishte qenë mirë, që me rastin e mbikëqyrjes së ligjeve, grupi punues të realizojë së paku dy vizita në ambasadat tona jashtë vendit, në mënyrë që raporti të jetë sa më i plotë.

Donika Kadaj-Bujupi, duke u ndërlidhur me diskutimin e z. S. Hyseni, shtoi se, kandidatët të cilët kanë aplikuar në MPJ, i janë nënshtruar intervistave dhe testeve të organizuara nga MPJ, por asnjëherë nuk kanë marrë ndonjë rezultat të poenëve, nga testimi dhe ende janë në pritje. Lidhur me këtë çështje, ajo tha se e kishte pyetur ministrin, nga i cili kishte marrë përgjigjen, se kjo çështje do të përfundojë në gjysmën e dytë të vitit, ndërsa ne tani jemi në fund të vitit dhe ende nuk ka ndonjë rezultat.

Sabri Hamiti, theksoi që raporti së bashku me plotësimet e dhëna, duhet të procedohet në Kuvend gjatë muajit dhjetor dhe të jetë i plotë e analitik. Lidhur me konkursin në MPJ, Hamiti tha, se esenca e problemit të këtij konkursi, nuk qëndron pse ai konkurs nuk është shqyrtuar, por në atë se, pse nuk janë rekrutuar edhe ajo pjesë e të paraqiturve, që në rast nevojë të MPJ-së, do të mund të hynin. Po ashtu çështja e gradimeve është një defekt i rëndë, dhe përderisa nuk ka kriter të vlerësimit, nuk do të kemi vlerësim të cilësisë së shërbimeve dhe do të humbim kuadro të shkëlqyeshme të diplomacisë sonë, theksoi Hamiti.

Albin Kurti, propozoi që raporti të plotësohet me sugjerimet e plotësimet e anëtarëve të Komisionit, si dhe të ceket në raport, se një pjesë e përgjigjeve nga takimi me zyrtarë të ministrisë, kanë qenë të përgjithshme dhe jo konkrete dhe se ka pasur mangësi në përgjigje për vendosjen e kontakteve me ambasadorë.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me propozimet e anëtarëve të Komisionit, dhe i njëjti të procedohet për shqyrtim e miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Albin Kurti, theksoi se buxheti i MPJ-së, për vitin 2013, krahasuar me vitin e kaluar, ka rritje mbi tre milion euro. Vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me buxhetin e MPJ-së, mund t'i parashtrohen komisionit kompetent për buxhet e financa. Bazuar në Projektligjin për buxhetin, Kurti tha se në MPJ, vërehet rritje e numrit të punëtorëve, rritje e të ardhurave personale, që nuk është e qartë sa dhe si është bërë, rritje e shpenzimeve komunale, pastaj të shpenzimeve për mobilimin e ambasadave dhe të shpenzimeve për pajisje teknologjike.

Propozoj, që për t'u njoftuar më hollësisht lidhur me buxhetin e MPJ-së dhe ndarjet buxhetore brenda ministrisë, të ftohet ministri në Komision.

Pas diskutimeve të deputetëve S. Hyseni, H. Hyseni, S. Hamiti, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të ftohet ministri i MPJ-së, z. Enver Hoxhaj, për të njoftuar lidhur me buxhetin e ndarjet buxhetore në ministri për vitin 2013 .

5. Të ndryshme.

Me rastin e vdekjes së z. Gani Azemit, këshilltar në Ambasadën e Kosovës në Bruksel, anëtarët e Komisionit shprehën nderimin dhe përkujtimin për kontributin e tij dhënë çështjes kombëtare.

Takimi përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

